



TIPOLOGJI TË FINANCIMIT

TË ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË



AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

HYRJE

Përhapja e armëve të dëmtimit në masë (ADM) dhe financimi i lidhur me to, përfaqëson një kërcënim serioz për sigurinë globale dhe integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar. Aktorët e shtetërorë dhe jo-shtetërorë, vijojnë të përfitojnë nga dobësitë në kontrollet e Financimit të Kundër-Përhapjes. Pasoja të konsiderueshme dhe katastrofike të ADM, e bën gjithnjë e më të rëndësishëm parandalimin dhe luftën kundër financimit të këtij aktiviteti të jashtëligjshëm.

Në këtë kuadër Agjencia e Inteligjencës Financiare, bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF) dhe organizmave të tjerë ndërkombëtar, ka përgatitur këtë përmbledhje të skemave të financimit të përhapjes së ADM duke nënvizuar rrezikun që vjen si pasojë e shmangies së sanksioneve, që përbën kërcënim serioz për sistemin financiar në vënd dhe në nivel ndërkombëtar.

Këto tipologji, nxjerrin në pah metodat dhe tendencat, teknikat e përdorura nga ata që shmangin sanksionet financiare të lidhura me financimin e ADM. Ato synojnë të përditësojnë njohuritë e subjekteve të legjislacionit në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të ADM (PP/FT/ADM) në Republikën e Shqipërisë, të identifikojnë sfidat në zbatimin e detyrimeve ligjore dhe praktikën më të mirë dhe vlerësimin e rrezikut.

Kërcënimet dhe dobësitë në zhvillim, që lidhen me fondet financiare dhe shmangien e sanksioneve paraqesin sfida të mëdha për sektorin publik dhe privat, pasi në nivel ndërkombëtar mjedisi aktual i rrezikut karakterizohet nga pjesëmarrja e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetëror që blejnë ose furnizojnë mallra, teknologji dhe njohuri me përdorim të dyfishtë përmes, përdorimit të rrjeteve të prokurimit.

Tipologjitë dhe treguesit përkatës, do të shërbejnë për të rritur njohuritë e strukturave përgjegjëse të parandalimit dhe punonjësve në subjektet e ligjit, trajnimin e vazhdueshëm të tyre si dhe përditësimin e vlerësimit të riskut PP/FT/ADM.

TIPOLOGJI Nr.1


PËRHAPJAE ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË DHE FINANCIMI I TYRE PËRMES KOMPANIVE FASADË DHE TREGTARËVE NDËRMJETËS

Kjo tipologji paraqet mënyrën bazë të financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë (ADM), e cila pasqyrohet në kompleksitetin e dorëzimit të mallrave të porositura dhe financimit (pagesës). Qëllimi është krijimi i një rrjeti kompleks transaksionesh mall-këmbim parash, me synimin për të fshehur burimin – origjinën e mallrave dhe furnizuesin (prodhuesin), si dhe përdoruesin e vërtetë (përdoruesin përfundimtar) të pajisjeve, teknologjisë ose mallrave me përdorim të dyfishtë (MPD).

Për të arritur këtë synim, përdoren kompani fasadë, të cilat kanë detyrë të ndërmjetësojnë në transaksione dhe të fshehin pjesëmarrësit realë në biznes, përkatësisht pronarët e vërtetë të kompanive. Prania e tregtarëve ndërmjetës (komisioner) është e zakonshme, me qëllim krijimin e një sërë hallkash të ndërmjetësimit të mallrave nga furnizuesi deri te përdoruesi final.

Krijohet një rrjet kompleks financimi, ku përfshihen shumë institucione financiare, kryesisht një zinxhir bankash të kombinuara që shtrihen nga banka legjitime deri te bankat në vendet që konsiderohen “parajsa fiskale”. Transporti i mallrave shpesh ndjek “linja” (itinerare) të ndërlikuara, më transport të kombinuar (detar, ajror, rrugor, hekurudhor).

Në skemën në vijim paraqitet në mënyrë grafike lidhjet mes palëve, zinxhiri i pagesave, kompanive, furnizuesve dhe ndërmjetësve.



TIPOLOGJI Nr.2


RRJET KOMPLEKS I PËRHAPJES SË ADM (PRODHUES DHE PËRDORUES FINAL I PANJOHUR, RRJET KOMPLEKS FINANCIMI)

Tipologjia paraqet një shembull bazë të financimit të përhapjes së ADM. Në varësi të situatës aktuale, pjesëmarrësit sillen në përputhje me rrethanat ekzistuese në fushën rregullatore, parandaluese dhe goditëse të rasteve të tilla. Praktika ka treguar se, kur bëhet fjalë për programet e përhapjes së ADM të shteteve të sanksionuara, si dhe për pjesëmarrjen e personave të listuar (të sanksionuar), aktiviteti është “i rrjetëzuar në mënyrë komplekse”, ashtu siç e paraqet kjo tipologji.

Numri i madh i ndërmjetësve në biznes dhe financimi i strukturuar, përmes një sërë bankash e vështirëson zbulimin e financimit të përhapjes së ADM. Transaksionet strukturohen nëpërmjet pagesave të shumta, shpesh nuk e ndjekin në kohë rrjedhën e mallrave (pagesa paraprake, pagesa të vonuara përtej afateve, etj.), dhe baza e pagesës është e dyshimtë.

Dorëzimi shpesh shoqërohet me dokumentacion të rremë ose të dyshimtë mbi origjinën dhe autenticitetin e mallrave.

Në skemën në vijim paraqitet në mënyrë grafike lidhjet mes eksportuesve ndërmjetësve, prodhuesve, kompanive fasadë dhe importuesve me strukturë pronësie kompleksepalëve, zinxhiri i pagesave, kompanive, furnizuesve dhe ndërmjetësve.




TIPOLOGJI Nr.3

FINANCIMI I PËRHAPJES SË ADM PËRMES MARRËVESHJEVE TË SHKËMBIMIT (SHLYERJA PËRMES SHKËMBIMIT TË MALLRAVE)

Kjo tipologji ilustron financimin e mallrave me përdorim të dyfishtë (MPD), të cilat mund të përdoren si për qëllime industriale, ashtu edhe për qëllime tregtare, pra janë objekt i tregtisë së zakonshme, por mund të jenë gjithashtu subjekt i një regjimi specifik të licencimit për eksportet. Për autoritetet kompetente dhe institucionet parandaluese, problemi qëndron te identifikimi real i MPD të destinuar për qëllime të përhapjes së ADM. Marrëdhëniet tregëtare mundësojnë dërgesa “të përziera” mallrash të destinuar për përhapjes së MPD, të kombinuara me mallra industriale dhe tregtare, shpesh me përshkrim të rremë të mallrave (dokumentacion i rremë). Fshehja e prodhuesve, furnizuesve origjinalë (pronarit real të mallrave) dhe përdoruesve finalë të mallrave, janë disa nga treguesit e këtyre rasteve.

Në skemën në vijim paraqitet në mënyrë grafike lidhjet mes prodhuesve, ndërmjetësve, kompanive fasadë, transporti i mallrave (MPD) dhe përdoruesit fundor.



TIPOLOGJI Nr.4


MËNYRA KOMPLEKSE TË FURNIZIMIT TË MALLRAVE ME TRANSPORT MES DISA ANIJEVE DHE DEVIJIM NË DISA DREJTIME

Përveç mënyrave bazë të përhapjes dhe financimit të ADM, të përshkruara në tipologjitë e mësipërme, kjo tipologji evidenton kompleksitetin e furnizimit të mallrave me qëllim fshehjen e origjinës së tyre dhe rrjedhimisht, fshehjen e origjinës së fondeve përmes rrjedhave të ndërlikuara monetare.

Pjesa e sipërme e ilustrimit paraqet një rrjedhë komplekse mallrash, e cila ka një itinerar (rrugë) të ndërlikuar nga nisja deri në marrje. Mallrat në tranzit (veçanërisht ato detare), për shkak të udhëtimit të gjatë, mund të bëhen objekt blerjeje dhe shitjeje, pasi faturat e ngarkesës detare përbëjnë një lloj titulli me vlerë dhe mund t'u transferohen mbajtësve (pronareve) të tjerë, gjë që e komplikon më tej zbulimin e origjinës së mallrave.

Transporti i mallrave mes disa anijeve në tranzit (transshipment) në një vend me sisteme të dobëta të kontrollit të mallrave dhe devijimi i tyre përmes rrugëve të ndryshme, me qëllim shmangien, të shoqëruara me dokumentacion tregtar të dyshimtë, e vështirësojnë më tej identifikimin e origjinës, ashtu si edhe të vetë mallrave. Rrjedhat monetare priren të jenë “të ndërlikuara dhe të strukturuar në mënyrë komplekse”.


Në skemën në vijim paraqitet në mënyrë grafike transferave mes anijeve, transporti i kombinuesë, kompanitë fasadë, pagesat e kryera, ndërmjetësit financiar, agjentët dhe përdoruesit fundor.



TIPOLOGJI Nr.5

FINANCIMI I PËRHAPJES SË ADM PËRMES SHTETEVE NDËRMJETËSE


Kjo tipologji paraqet shtetin ndërmjetës (B) si një hallkë ndërmjetëse në zbatimin e programit të përhapjes së ADM të shtetit A. Këto shtete mbështesin zhvillimin dhe financimin e ADM për qëllime ushtarake, interesa gjeopolitike, ose që promovojnë qëndrime radikale–terroriste.



TIPOLOGJI Nr.6

NUMËR I MADH PJESEMARRËSISH NË PËRHAPJEN E ADM: PRODHUES, FURNIZUES, KONTRAKTORË, INSTITUCIONE FINANCIARE


Ky rast paraqet kompleksitetin e financimit të ADM, nga këndvështrimi i prokurimit, furnizimi dhe pagesës. Tipologjia merr si shembull mallrat me përdorim të dyfishtë (një numër i madh artikujsh MPD), të cilat përbëjnë një bazë për krijimin e një rrjeti pjesëmarrësish përmes kompanive fasadë. Një diversifikim kaq kompleks i rrjedhës së mallrave ul ndjeshëm rrezikun e zbulimit dhe sekuestrimit të tyre, për shkak të numrit të madh të furnizuesve, zakonisht kompani fasadë, të cilat në fakt fshehin pjesëmarrësit realë në aktivitet (pronarët) dhe legjitimitetin e biznesit. Vlerat monetare kanalizohen nëpër “parajsave fiskale” përmes kompanive fiktive ose shpesh përmes personave juridikë të huaj (trustet), me ndërmjetësimin e një numri të madh bankash, gjë që e vështirëson identifikimin e origjinës dhe të lëvizjeve të parave. Për shkak të kompleksitetit të aktivitetit, është i mundur edhe roli i një koordinatori të biznesit (zakonisht person me reputacion të dyshimtë, me shtetësi të dyfishtë, jo-rezident), i cili mund të jetë edhe person me njohuri të thelluara profesionale në fushën e përhapjes së ADM (p.sh. personel në fushën kërkimore dhe shkencore).



TIPOLOGJI Nr.7

FINANCIMI I ADM PËRMES KËMBIMEVE VALUTORE DHE ORGANIZATAVE JO-FITIMPRURËSE (OJF)


Ky rast ilustron mbështetjen nga simpatizantët dhe përkrahësit e përhapjese dhe financimit të ADM përmes një rrjeti zyrash këmbimi valutor ose përmes organizatave jofitimprurëse (OJF). Në këtë rast, rrjedha kryesore e parave është në para, prandaj pikat e këmbimit valutor janë veçanërisht të ekspozuara ndaj rrezikut. Në rastin e OJF-ve, programet e financimit të ADM mund të maskohen si veprimtari bamirësie, shpesh pa dijeninë e donatorëve, duke bërë që donatorët të financojnë pa dijeninë e tyre, të aktivitetit të financimit të ADM.



TIPOLOGJI Nr.8

PËRFSHIRJA E KOMPANIVE TË RREGULLTA ME SHTETE NË SANKSIONE OSE PERSONA TË LISTUAR, OSE ME SHTETE QË DIHET SE KANË PROGRAME TË FINANCIMIT TË ADM


Mungesa e politikave dhe procedurave efektive parandaluese të subjekteve raportuese (kryesisht institucionet financiare), krijohen hapësira që mund të kontribuojnë në financimin e ADM në mënyrë “të pavetëdijshme” dhe dëmtimin e reputacionit të tyre. Përveç bankave, edhe kompani me reputacion të mirë mund të gabojnë, veçanërisht kur partneri u paraqet “në moment” urdhëra të dyshimta dhe të pazakonta për transfertë fondesh.



TIPOLOGJI Nr.9

PËRFSHIRJA E PERSONAVE FIZIKË DHE E INSTITUCIONEVE KËRKIMORE-SHKENCORE NË FINANCIMIN E ADM

Përvoja praktike tregon se disa individë nga komuniteti shkencor dhe kërkimor, si edhe institucione kërkimore-shkencore, synojnë të përfitojnë nga njohuritë e tyre ose mallrat që mund të përdoren për financimin e ADM, duke bashkëpunuar me shtete nën sanksione ose me persona të shpallur. Në këtë rast vihet re fshehja e qëllimit të marrëdhënieve të biznesit, pagesa të shumëfishta të mallrave përmes ndërmjetësve (kompani fasadë) dhe një rrjeti bankash.




TIPOLOGJI Nr.10

STRUKTURË E NDËRLIKUR MALLRASH (TREGTARE DHE MPD) DHE DOKUMENTACION TREGTAR (TË VËRTETË DHE TË RREMË)

Financimi i tregtisë është një sërë veprimesh që ndërmerren për të siguruar ekzekutimin e një marrëveshjeje tregtare. Ai shërben si një lloj garancie që furnizuesi do të marrë pagesën e tij dhe blerësi do të marrë mallrat. Sigurisht, një pjesë e rëndësishme e këtyre veprimtarive lidhet me dokumentacionin tregtar dhe financiar (fatura/fatura ngarkese, specifikime të mallrave, lista paketimi, etj.).

Me qëllim fshehjen e mallrave me përdorim të dyfishtë që janë nën regjimin e licencës së eksportit dhe që mund të përdoren për përhapjen e ADM, por që mund të paraqiten edhe si mallra për përdorim industrial-tregtar, krijohet dokumentacion i rremë i transportit dhe shoqërimit (kod tarifor i rremë i mallrave, fatura, specifikime të mallrave, fletë-dërgesa, etj.) me synimin që një numër i madh artikujsh të dërguar, që në fakt janë nën regjimin MPD, të paraqiten si mallra industriale-tregtare për të anashkaluar sanksionet e parashikuara. Shpesh, mallrat përzihen (MPD + tregtare) dhe dërgohen përmes një vendi tranzit ose përmes disa prej tyre, drejt një numri të madh kompanish të rregullta apo dhe kompani fasadë, për të diversifikuar dhe ulur rrezikun e dorëzimit për shkak të mundësisë së sekuestrimit të MPD ose artikujve të veçantë (nën regjimin e licencës së eksportit), nëse zbulohen gjatë transportit drejt destinacionit final. Pas mbërritjes, mallrat MPD përdoren në kuadrin zbatimit të programit të financimit të ADM.


Dorëzime përmes një shteti ndërmjetës
(të gjitha kompanitë në një shtet) – mundësisht edhe më shumë shtete ndërmjetëse



TIPOLOGJI Nr.11

FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE ADM PËRMES KONTRABANDËS SË METALEVE TË ÇMUARA


Ky rast tipologjik paraqet financimin e terrorizmit (FT), të organizatave terroriste dhe grupeve terroriste në mënyrën e zakonshme për terrorizmin, përmes nxjerrjes (minierave) të metaleve të çmuara (ar, argjend, platini, etj.) dhe kontrabandës me synim legalizimin e tyre për shitje të mëtejshme dhe sigurimin e mjeteve financiare për veprimtari terroriste dhe të proliferimit. Ilustrimi paraqet qartë rrjedhën e kontrabandës së mallrave (metaleve të çmuara), të cilat “pastrohen” dhe legalizohen në shtetin “C” dhe më pas bëhen objekt eksporti drejt shtetit “D”, ku përfundon përpunimi dhe realizohet shitja e tyre. Mjetet financiare të përftuara zakonisht përfundojnë në duart (në të holla) e terroristëve, ose realizohen transferata legale në shumën më të vogël (nën pragun e raportimit nga subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit). Paratë e siguruar përdoren për veprimtari terroriste dhe si mbështetje për një shtet të sanksionuar për zhvillimin e programeve të përhapjes së ADM. Është e mundur gjithashtu një lidhje me “persona të shpallur” ose persona që mbështesin programet e ADM.



TIPOLOGJI Nr.12

ROLI I ORGANIZATAVE JO-FITIMPRURËSE (OJF) NË FINANCIMIN E ADM – MBËSHTETJE PËR “PERSONAT E SHPALLUR” DHE, TËRTHORAZI, PËR SHTETET ME PROGRAME TË FINANCIMIT TË ADM


Ky rast dhe skema përkatëse paraqet rolin dhe mundësinë e keqpërdorimit të organizatave jofitimprurëse (OJF) në mbledhjen e fondeve për financimin e terrorizmit dhe financimin tërthorazi të ADM. Një OJF, në varësi të fushës së aktivitetit, mund të tërheqë një numër të madh donatorësh, nëpërmjet programit të saj. Keqpërdorimi i mundshëm reflektohet në programe fiktive, të cilat mund ta mashtrojnë publikun e gjerë dhe donatorët, duke i bërë të besojnë në aktivitetet bamirëse, kur në fakt po financojnë terrorizmin. Nëpërmjet veprimtarive të mëtejshme, OJF-ja financon “persona të shpallur” dhe, në mënyrë të tërthortë, një shtet me program të financimit të AMD, përmes korrierëve të transfertave të parave.



TIPOLOGJI Nr.13

ROLI I KOMPANIVE FASADË NË FINANCIMIN E TERRORIZMIT (FT) DHE ADM


Duke maskuar pjesëmarrësit realë (pronarët), ndërkohë që ruhet pamja e një aktiviteti të ligjshëm biznesi, kompania fasadë fsheh ose kryen veprimtaritë joligjore të pjesëmarrësve në këto biznese. Kompanitë “fasadë” i shndërrojnë metalet e çmuara të kontrabanduara (ose mallra të tjera me vlerë) në asete investimi që gjenerojnë të ardhura dhe fitim, dhe më pas i investojnë ato, përmes transfertave të ligjshme, në një OJF që është e lidhur me organizata ose grupe terroriste që mbështesin financues të ADM.



TIPOLOGJI Nr.14

FINANCIMI TREGTAR I ADM PËRMES DOKUMENTACIONIT FIKTIV


Me qëllim fshehjen e MPD për veprimtari terroriste, të cilat janë nën regjimin e licencës së eksportit dhe mund të përdoren për përhapjen e ADM, por që mund të paraqiten gjithashtu si mallra për përdorim industrial-tregtar, krijohet dokumentacion i rremë i transportit dhe dokumentacion shoqërues (kod tarifar i rremë i mallrave, fatura, specifikime mallrash, fletë-dërgesa, etj.), me synimin që një numër i madh artikujsh dërgese MPD (për ADM) të paraqiten si mallra industriale-tregtare, për të anashkaluar sanksionet e parashikuara. Mallrat kalojnë përmes një vendi tranzit dhe në dërgesa të pjesshme drejt një numri të madh kompanish (ndoshta kompani fasadë), për të diversifikuar dhe ulur rrezikun e dorëzimit, për shkak të mundësisë së sekuestrimit të MPD-ve ose artikujve të veçantë (nën regjimin e licencës së eksportit), nëse zbulohen gjatë transportit drejt destinacionit final.



TIPOLOGJI Nr.15

Aktor shtetëror, banka dhe shoqëri të përfshira në një rrjet të ADM

Një autoritet kombëtar përkroi shembullin e një transaksioni që përfshinte ndërmjetës në disa shtete (shih diagramin më poshtë). Duhet vënë re mënyra se si fshihej përfshirja e subjekteve të shpallura: një porosi blerjeje u vendos nga një subjekt i listuar (Organizata e Energjisë Atomike të Iranit). Porosia e blerjes iu përcoll një kompanie fasadë. Pagesa u iniciua nga një kompani e dytë fasadë në Iran, përmes një subjekti tjetër të shpallur, Bank Sepah, i cili transferoi fondet përmes një kompanie Iraniane me aktivitet nee fusheen e prodhimeve ushqimore, drejt një banke Iraniane jo të sanksionuar nga OKB-ja. Prej andej, transferimi u bë përmes një banke në shtetin A, drejt një banke në shtetin B.



Diagramë: skema e një transaksioni që përfshin ndërmjetës në disa shtete

- Një shtetas i huaj themeloi një kompani tregtare në një shtet në Lindjen e Mesme dhe hapi një sërë llogarish në emër të kompanisë në një bankë ndërkombëtare në atë shtet. Këto llogari ishin në monedhë vendase, euro, dollarë amerikanë dhe valuta të tjera të huaja. Monitorimi nga banka tregoi se llogaria e kompanisë tregtare merrte fonde në monedhë vendase vetëm nga një burim i vetëm (një kompani e dytë e krijuar nga një shtetas tjetër i huaj). Këto fonde në monedhë vendase më pas shndërroheshin shpejt në valuta të huaja dhe transferoheshin jashtë vendit. Kjo veprimtari nxiti hetime nga banka, të cilat treguan se pronarët e kompanive të përfshira kishin lidhje me Iranin. Banka dyshoi se fondet po vinin nga Irani dhe po kanalizoheshin përmes kompanisë tregtare në sistemin financiar global.
- Një shtetas i huaj themeloi një kompani tregtare në një shtet në Lindjen e Mesme dhe hapi një llogari në emër të kompanisë në një bankë ndërkombëtare në atë shtet. Monitorimi nga banka tregoi një qarkullim shumë të lartë fondesh dhe u dyshua për pastrim parash. Hetimet e bankës treguan se punësimi i deklaruar i shtetasit të huaj ishte si anëtar stafi në një kompani të dytë, e cila kishte të njëjtin numër telefoni si kompania tregtare. Hetime të mëtejshme zbuluan se ky numër telefoni ishte i njëjtë me atë të dy kompanive të tjera, të identifikuar më parë nga banka, të cilat kishin aksionerë iranianë dhe ishin të përfshira në biznes me Iranin. Banka, prandaj, dyshoi se kompania tregtare po përdorej si kompani fasadë për biznes iranian.
- Një shtetas i një vendi në Lindjen e Mesme, themeloi një kompani në atë shtet në partneritet me një shtetas të huaj si aksioner minoritar dhe hapi një llogari në emër të kompanisë në një bankë ndërkombëtare në atë shtet. Nga kjo llogari u kryen disa pagesa të mëdha drejt disa kompanive me të njëjtën adresë në një shtet evropian, si dhe drejt një grupi të dytë kompanish me një adresë të përbashkët në një shtet të dytë evropian. Monitorimi nga banka e identifikoi këtë model si të mundshëm për pastrim parash dhe hetime të mëtejshme zbuluan se shtetasi i atij vendi në Lindjen e Mesme ishte gjithashtu menaxher i një kompanie tjetër që bënte biznes me Iranin.
- Një pagesë për shpenzime transporti, ku përmendeshin dy kompani logjistike, por pa asnjë referencë ndaj Iranit: me kërkesë të institucionit financiar, u paraqit një faturë. U zbulua se kjo faturë përmbante një numër reference të faturës së ngarkesës. Pas gjurmimit të këtij numri fature, konstatua se destinacioni final i ngarkesës ishte Irani.
- Një pagesë për një kompani në një shtet fqinj me Iranin: politika e institucionit financiar ishte të aplikonte vigjilencë të zgjeruar, kur bëhej fjalë për kompani në atë shtet të veçantë dhe, si rezultat, u zbulua se kjo kompani (përfituesja e pagesës) ndodhej në Iran. Adresa në shtetin fqinj ishte e rreme.
- Një Letër Kredie(LK) importi që mbulonte një dërgesë mallrash: mallrat vinin nga shteti A në Azinë Jugore dhe, në dukje, duhej të niseshin nga shteti B, fqinj me Iranin, drejt shtetit C në Afrikën Veriore. Institucioni financiar shqyrtoi më tej LK, nga ku rezultoi se dërgesa ishte kryer nga një kompani e tretë, e cila ishte iraniane. Përfituesi i LK në shtetin fqinj B, po vepronte si kompani fasadë për kompaninë Iraniane, e cila ishte pronari real përfitues nga LK.
- Një pagesë që mbulonte mallra të dërguara nga shteti A në Afrikën Veriore drejt shtetit B fqinj me Iranin: një rishikim i dokumentacionit përkatës të transportit nga institucioni financiar ndërkombëtar zbuloi se mallrat, në fakt, ishin në tranzit për në Iran.
- Një kompani A, në Iran hyri në një marrëveshje me një kompani B të vendosur në një shtet në Lindjen e Mesme, sipas së cilës kompania B ra dakord të pranonte ose procesonte pagesa në emër të



kompanisë A. Kompania B kishte një llogari bankare në një institucion financiar jo-iranian. Kompania A i informoi klientët e saj që pagesat t'i drejtonin te kompania B dhe i informoi përfituesit që të prisnin pagesa nga banka e kompanisë B. Nuk dihet se si është kryer transaksioni financiar midis kompanisë B dhe kompanisë A në Iran.

- Një shtetas Iranian me një biznes të konsoliduar në Iran, që shiste mallra brenda vendit dhe jashtë, u largua nga Irani dhe vazhdoi të ishte pronar dhe të merrte të ardhura nga biznesi i tij në Iran. Të ardhurat merreshin në formën e transfertave ndërbankare nga institucione të vogla financiare të vendosura në shtete fqinje. Llogaritë në këto institucione financiare, nga të cilat dërgoheshin transfertat, ishin të lidhura me kompani të vendosura jashtë Iranit.

Një kompani jo-iraniane A (jashtë Iranit), tentoi të dërgonte një pagesë te një kompani B brenda Iranit: kompania A dërgoi pagesën në një numër specifik llogarie, që pretendohet se i përkiste kompanisë B, në një bankë brenda Iranit. Pagesa u refuzua nga një institucion financiar ndërkombëtar dhe u paraqit një raport pranë autoriteteve. Më pas, kompania A organizoi një pagesë të dytë për një shumë të përafërt, në favor të një kompanie përfituese C (jashtë Iranit). Numri i llogarisë përfituese ishte i njëjti numër llogarie si ai i kompanisë B, në pagesën fillestare. Nuk dihet nëse dhe si kjo pagesë e dytë e tentuar do të kishte mbërritur te kompania B dhe asnjë lidhje mes kompanisë iraniane B dhe kompanisë përfituese C, nuk u zbulua nga kërkimet në burime të hapura.

TIPOLOGJI Nr.16

KOMPANI FASADË (FIKTIVE) NË NJË RRJET TË ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË

Një tipologji standarde që evidentohet shpesh në shumë dokumente të Njësive të Inteligjencës Financiare, që lidhet me financimin e ADM përfshin përdorimin e kompanive fasadë, ndërmjetësve, importuesve dhe kanalizimit të transaksioneve nëpërmjet bankave.

